

Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë

# Qendra për Trajnim Themelor Policor Sremska Kamenica

Trajnimi themelor ju mundëson të fitoni dijeni dhe aftësi të nevojitur për kryerjen e detyrave policore në mënyrë profesionale.

## Kushtet e përgjithshme për regjistrim:

- shtetësia e Republikës së Serbisë;
- që kandidati të mos ketë shtetësi duale;
- që kandidati të mos jetë i sanksionuar penalisht ose që kundër tij të mos jetë udhëhequr procedura penale;
- të ketë më shumë se 18 vjet, dhe më pak se 25 vjet;
- shkolla e mesme e kryer, dhe
- të ketë kaluar me sukses provimin pranues në Qendrën e trajnimit.

## Kushtet e posaçme për regjistrim:

- patent shoferi për kategorinë B të automjeteve;
- kandidati duhet t'i plotësojë kriteret të kontrollimit shëndetësor, psikologjik dhe trupor;
- gjatësia minimale për femra është 163 cm, kurse për meshkuj është 170 cm.

**Obligimi i pjesëmarrësve** gjatë trajnimit, përveç tjerave, është zotësimi i notit.

## Provimi pranues përbëhet nga:

- kontrollimi mjekësor;
- testimi psikik në gjuhën amtare;
- kontrollimi i aftësive trupore;
- kontrollimi i kulturës së përdorimit të gjuhës, drejtshkrimit, dhe
- intervista.

Për informata të hollësishe mund të informoheni në numrin telefonik të Qendrës për Trajnim ose të Drejtorisë Rajonale të Policisë në vendin tuaj.

Formularin për aplikim në Konkurs mund ta merrni në stacionin policor – në stacionet e Drejtorisë Rajonale të policisë në vendbanimin tuaj, ku edhe do ta dorëzoni formularin të plotësuar dhe të parashtroni të gjithë dokumentacionin e nevojitur.



## Министарство унутрашњих послова Републике Србије



## СРЕДЊА ШКОЛА УНУТРАШЊИХ ПОСЛОВА ЦЕНТАР ЗА ОСНОВНУ ПОЛИЦИЈСКУ ОБУКУ Сремска Каменица

Železnička 22, 21208 Sremska Kamenica  
tel. 021/462 033, lok. 137, faks 021/461 816  
www.copo.edu.rs  
e-mail: ssupoffice@mup.sr.gov.rs  
office@copo.edu.rs



Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë



# EDHE JU MUNDENI!



LIGJSHMËRIA



DINAMIKA



SFIDAT

# Qendra për Trajnim Themelor Policor Sremska Kamenica

Të rinj, ambicioz dhe të vetëbindur  
Ju tërheqin sfidat, aksioni dhe dinamika  
Vend pune të siguruar

Trajnimi themelor zgjat 42 javë dhe zbatohet në Qendrën për Trajnim Themelor në Sremska Kamenica dhe në Drejtoritë Rajonale Policore. Në Qendrën bashkëkohore do të ndjekin trajnime meshkujt dhe femrat në bazë të planprogramit i cili i përfshin tri fusha:

- **Modulet profesionale** (Puna e policisë në sektorin e sigurisë, Puna e policisë me bashkësinë, Përdorimi i autorizimeve policore dhe mjeteve policore, Parandalimi i kriminalitetit, Ruajtja e rendit publik dhe sigurimi, Kontrollimi dhe rregullimi i komunikacionit);
- **Aftësitë policore** (Komunikimi, Gjuha huaj, Sistemet e informatikës, Sistemet e komunikimit, Aftësi fizike Aftësitë mbrojtëse, Përdorimi i armëve të zjarrit dhe gjuajtja me armë zjarri, dhe Ndhimja e parë);
- **Temat e përgjithshme për punën e policisë** (Të punësuarit policorë: Të drejtat, obligimet dhe detyrat, E Drejta Penale dhe e Drejta e Procedurës Penale, Punët administrative dhe Procedura kundërvajtëse, Të Drejtat e Njeriut dhe Kodi i Etikës policore, Bazat e sigurisë dhe Aspektet tjera të higjienës mendore.)

Shkalla e parë e specializimit  
Tuaj profesional dhe të avancimit  
në polici

**Qendra ju ofron falas:**

- trajnim profesional të bazuar në parime më moderne;
- material edukativ;
- akomodim në dhomat me dy krevate në internat me pajisje moderne në Qendër, dhe
- ushqim në restorantin e Qendrës

**Dispononi me:**

- kabina të pajisura në mënyrë moderne;
- fusha trajnimi dhe lokale të planifikuara për trajnim të policisë;
- bibliotekë dhe dhomë leximi;
- fush sporti;
- hall për sport dhe salla për taktikat mbrojtëse;
- kinema;
- ambulancë;
- dhomat për klube të ndryshme...

Pas gjashtë muajve të punës praktike dhe provimit profesional të kaluar me sukses do t'ju ofrohen shansët të kryeni detyra të llojllojshme në mënyrë profesionale.

